

VENDIM
Nr. 371, datë 2.5.2013

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 480, DATË 22.6.2011 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES MODEL TË PLANIFIKIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6 të nenit 88 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në shtojcën 1 “Rregullorja model e planifikimit”, bashkëlidhur vendimit nr. 480, datë 22.6.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas shkronjës “d” të pikës 2 të nenit 2, shtohen shkronjat “dh” dhe “e” me këtë përmbajtje:

“dh) përcaktimin e përdorimit të lejuar të tokës deri në hartimin e instrumentit të përgjithshëm vendor të planifikimit;

e) përcaktimin e parametrave zhvillimorë të lejuar deri në hartimin e instrumentit të përgjithshëm vendor të planifikimit.”.

2. Pas shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 4, shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) zhvillimin e strukturave me funksion administrativ në arsim, bujqësi, industri ushqimore, ekonomi ndihmëse bujqësore, shëndetësi, infrastrukturë, transport, e strukturave ushtarake, institucioneve fetare, shërbimeve tregtare, magazinave tregtare, shërbimeve sociale.”.

3. Në pikat 2, 3, 4 dhe 6 të nenit 7, fjalët “... kategori ekzistuese të përdorimit të tokës ...” zëvendësohen me “... kategori ekzistuese dhe të lejuara të përdorimit të tokës ...”.

4. Në pikën 1 të nenit 8, fjalët “... kategori ekzistuese të përdorimit të tokës ...” zëvendësohen me “... kategori ekzistuese dhe të lejuara të përdorimit të tokës ...”.

5. Në shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 9, fjalia “Intensiteti i ndërtimit të nënjjesisë strukturore” zëvendësohet me “Intensiteti i ndërtimit të nënjjesisë strukturore për kategorinë e tokës A. Banim”.

6. Kudo në tekstin e rregullores, termi “Rregullore kombëtare e planifikimit” zëvendësohet me “Rregullore uniforme e instrumenteve të planifikimit”.

II. Ngarkohen autoritetet e planifikimit, të përcaktuara në nenet 5 e 12 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha